

## THIRRJE PËR PROTESTË



### **Të nderuar bashkatdhetarë nga të gjitha trojet shqiptare,**

Terrori shtetëror i IRJM nuk ka të ndalur mbi vendbanimet shqiptare. Ngjarjet e Kumanovës edhe njëherë dëshmuar se forcat policore dhe ushtarake të udhëhequra nga zyrat e shtetit janë në gjendje brenda dy ditësh të rrënojnë çdo gjë shqiptare.

Faktet mbi Masakrën e Kumanovës, dëshmuar dhe dëshmojnë se në IRJM zbatohen projekte antishqiptare të cilat janë të dënueshme sipas të gjitha ligjeve ndërkombëtare.

Prandaj, ne Shoqata "Liria Kombëtare" në Zvicër së bashku me shoqatat tjera, në bashkëpunim me intelektualë, veprimtarë të çështjes kombëtare, sportistë dhe artistë fton të gjithë mërgimtarët në një

### **PROTESTË PAQËSORE KUNDËR DHUNËS DHE TERRORIT SHTETËR NË KUMANOVË, para Selisë së OKB-së , në Gjenevë, me datën 16.05.2015, në ora 14.00**

duke kërkuar institucioneve ndërkombëtare hetim të pavarur ndërkombëtar për ngjarjen e Kumanovës, si dhe për ngjarjet tjera.

Urdhërdhënësit dhe aktorët në Masakrën e Kumanovës duhet të dënohen për krime kundër njerëzimit. Askush nuk ka të drejta me forca policore, me mjete të blinduar të shkatërrojnë vendbanimet shqiptare.

Marrin pjesë përfaqësues të shoqatave shqiptare në Zvicër, intelektualë, sportistë të dalluar, artistë ...

Në emër të Shoqatave shqiptare në Zvicër

Dr. Vaxhid Sejdiu

Tel. 076 321 26 94